



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. & fax. 00355 218 229 37

Sektori i Financës

PROJEKT - VENDIM

Nr. 15 datë 23/09/2024

"Per Perdorimin e Fondit Rezerve, nga Granti & Te Ardhurat"

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ___/___/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 18, 34, 40, 41, 54, shkronja "dh", 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, keu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 44, pika 4, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhmin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.24/1 prot datë 11.01.2024 i ndryshuar :

KERKOJME:

- I. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t'i jepet ndihmë financiare për Shoqatën Kulturore "Oda Dibrane" si më poshtë:
 - I- Për festivalin Mbarëkombëtar "Oda Dibrane" 2024 edicioni i 30-jubilar që do të zhvillohet në muajin Tetor 2024, në qytetin e Peshkopisë, ku do të marrin pjesë grupe nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva ta mbështesë në vlerën 100.000 (njqindmijë) lekë.
- II. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1110** Kapitulli 1 llogaria ekonomike **609** në vlerën 100.000 (njqindmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** kapitulli 1 llogaria ekonomike **604** ne vleren 100.000 (njqindmijë)lekë.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

IV. Ky vendim njih ne tuqi pas shprehjes per bazueshmeri ligjore nga institucioni i Prerekitit te Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtore Juridike
Ismet SARAÇI



Sp/Buxheti
Erblina SELA




Drejtore Ekonomike
Çeljeta Zuna



KRYETARI

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELE SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Shoqata Odit DORRË dhe mban nga dërguesi nr 15 pr
date 18.01.2024 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) _____

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 232 datë 18.01.2024

Praktika u drejtohet për administrim:
-Znj/Z Secretariatit FOSHILLI
-Znj/Z _____
-Znj/Z _____
-Znj/Z _____

me porosi

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktiken (përgjigjen) shkresore: _____

Peshkopi, më 18.01.2024

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQATA KULTURORE ARTISTIKE "Oda DIBRANE"
DIBER

Nr. 15 Prot.

Peshkopi me 18.01.2024

Lenda : Kerkese per mbeshtetje financiare.

KESHILLIT TE BASHKISE DIBER
KRYETARIT TE BASHKISE DIBER

Z. Rrahim SPAHIU

Te nderuar.

Me lejoni t'u informoj qe ne fillim te muajit tetor 2024 ne qytetin e Peshkopise do te zhvillohet **edicioni** i 30-te i festivalit mbarekombetar "ODA DIBRANE". Festivali yne "Oda Dibrane" tashme i ka kaluar te gjitha provat dhe ka treguar se eshte nje festival i konsoliduar dhe me vlera.

Nuk ka festival tjetër me kete jetegjatesi, me keto cilesi. dhe ka reputacionin e nje nga festivalet me serioze ne vend. i vleresuar nga specialistet si me i rëndësishmi pas atij te Gjirokastres.

Në te marrin pjesë grupe folklorike e popullore nga Shqipëria, Kosova, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi e te Lugines së Preshëves.

Kjo veprimtari mbarëkombëtare do të ndikojë në promovimin dhe ballafaqimin e vlerave kulturore të trojeve të ndryshme shqiptare në dobi edhe të propagandimit të turizmit kombëtar në përgjithësi dhe turizmit kulturor të qytetit të Peshkopisë në veçanti duke ndihmuar edhe në gjallërimin e biznesit vendas.

Ky projekt do të bëjë të mundur edhe njohjen dhe promovimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Dibres me anën e vizitave pranë tyre që do të zhvillohen gjatë ditëve të këtij Festivali.

"ODA DIBRANE" ka si qellim te pare te bashkoje artistet shqiptare pavaresisht nga kufijte, me idene se "ODA DIBRANE" do te jete mikpritese e "ODES SHQIPTARE".

- Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "Oda Dibrane" është manifestim tepër i bukur i artit tradicional popullor. Ne kete festival, rizbulohen e risillen ne skene, behen te asimilueshme per brezat e rinj, vlerat e trashëgimisë kulturore shpirtërore të të gjitha viseve ku banojnë shqiptarët e me gjere.

Ky festival jep nje kontribut te rëndësishem në promovimin e vlerave të folklorit e tradites shqiptare.

- Te gjalleroje jeten kulturore dhe artistike ne qytetin e Peshkopise si nje qytet me infrastrukture dhe institucione kulturore.

Kete vit nata e pare, 10 tetor 2024 eshte planifikuar te jete ne Diber te Madhe, Maqedoni e Veriut dhe me dt 11 dhe 12 tetor 2024, ne Peshkopi.

232
18/01/24

Ne ditet e festivalit do te kete parade kostumesh popullore ne te dy Dibrat (Shqiperi dhe Diber e Madhe ,Maqedoni e Veriut),ekspozite fotografike, ekspozite piktore,panair te prodhimeve bujqesore (kete e organizon Bashkia Diber) etj.

Kete vit si edicion jubilar eshte menduar te hapet nje panair libri i autoreve dibrane dhe botimeve per Dibren.

Ne 30 vite,ky festival eshte mbeshtetur nga shume institucione, shoqata, biznese e ,individe te ndryshem. Eshte detyrimi yne qe te gjithë ata qe na kanë ndihmuar ne keto 29 vite ti vleresojme, ti permendim ne botimin tone e me e rendesishmja ti vleresojme me nga nje "mirenjohje".

Nese sigurohet financimi i nevojshem do te kete nje botim te nje reviste me titull "30 vjet ode dibrane".

Grupet qe mendohet te marin pjese ,veç atyre konkruuese do te jene dhe Ansambli i kengeve e valleve i Shqiperise, Ansambli kombetar "Shota" i Kosoves dhe Ansambli popullor i shqiptareve nga Shkupi, Maqedoni e Veriut. Keto do te jene pershendetes.

Grupe te tjera do te jene te zgjedhura nga me cilesoret e nga treva te ndryshme qe perbejne bazen e folkut shqiptar. Kete vit pjesmarres per here te pare do te jete nje grup artistik nga arbereshet e Italise.

Por duke qene i ketyre permasave, e kemi te pamundur ti plotesojme te gjitha kerkesat vetem me mbeshtetjen finaciare te Ministrise se Kultures te Shqiperise qe gjithsesi mbetet partneri yne kryesor, apo mbeshtetjen e disa donatoreve te rendesishem.

Veçanerisht ky vit eshte vit jubilar,e kerkon nje mbeshtetje me te madhe finaciare.

Ne besojme shume qe kete vit partner i rendesishem do te jete edhe Bashkia Diber.

Shpresojme qe Ju te mbeteni pjese e rendesishme e realizimit te fest. tone **30 vjet Ode Dibrane.**

Ne besojme realisht, qe Ju do te jeni bashkefinancues me nje shume **700,000** (shtate qind mije) lekë.

Njekohesisht ,ashtu si tashme eshte bere tradite, çmimi i pare shperblehet me shumen **100.000** (njeqind mije) nga Keshilli i Bashkise.

Ne shpresojme,qe duke vlerësuar permasat e aktivitetit, shtrirjen gjeografike të tij,numurin e pjesëmarrësve si dhe në mënyrë të veçantë vlerat e ralla e të papërsëritëshme të këtij Festivali, do të na ndihmoni, që edhe këtë vit, ky aktivitet,si një ngjarje e madhe kulturore në vend, të realizohet me sukses.Ne si organizatore,por jemi te bindur qe dhe vete qytetaret e Diber do t'u jene mirenjohes.

Me konsiderate

DREJTORI I FESTIVALIT :

Veli VRANIÇI (Mjeshtër i ...)

